


BIBLIOTEKA

844-1

H87

HASAN HUTA

zérat e jetës



poezi

8SH-1
H77

Hasan Huta

LIBRARY
PREZ NOGATI

VALDIT SIMONJ NURMI

LIBRARY
KOSTAV NTHONGA

LIBRARY
KOSTAV NTHONGA

LIBRARY
KOSTAV NTHONGA

LIBRARY
KOSTAV NTHONGA

Zërat

e jetës



POEZI

LIBRARY

LIBRARY

LIBRARY

SHTËPIA BOTUÈSE

«NAIM FRASHËRI»

otkut amazit

Redaktor
PREÇ ZOGAJ

Piktor
KOSTAQ ZHONGA

Recensues
Bardhy Londo
Xhezair Abazi

*IZDANJE ALPITRE
ALPITRE MIAK*

VALET SHKOJNË TUTJE

Valë të pafundme njerëzore
shkojnë tutje,
shkojnë tutje dhe lart
sikur shkojnë drejt pllajash.

Eci edhe unë bashkë me ta
nëpër këtë rrugë të gjerë, të thjeshtë,
nën ritmin-marsh të kohës sonë
duke çarë me balle shiun diellor.

Gurët anash dhe lulet,
dhe peizazhi i përjetshëm i tokës
na e bëjnë me dorë
të ndezur nga një gaz i brendshëm njerëzor.

Kurse akoma më tutje, më tutje, presin
madhërishëm në heshtje
kohërat dhe hapësirat dhe njerëzit e rinj
të hyjnë në histori.

NE BREG TE DETIT

C'gaz madhështor i pacak,
c'reflekse jete dhe endrrash kumbojnë këtu!

Përrenj dhe oshëtima malore buçasin në
mua.

Si një ortek i virgjër, i zgjuar jam,
i sapodalë nga shpërgënjtë e gurtë të vendlindjes
dhe i shkrirë vrullshëm me hapësirën.

S'di pse ndiej dëshirë të loz dhe të qesh si
fëmijë
me detin, qiellin,
me këtë materie të butë, naive;
të ndihem i qenë në ta,
të kalëroj, ta bëj të pëlleshëm këtë xhungël
elementesh fluoreshente
që harbojnë në madhështinë e tyre shterpe.

KALTE DHE GURET

Që nga shpellat e largëta të horizonteve
ngrihen dhe rendin drejt bregut radhët e
dallgëve,
dhe mua më perceptohet si e gjallë
rendja e pambarim e brezave njerëzore
drejt horizonteve të reja të jetës,
drejt zotërimit të botës,
drejt zotërimit të vetes.

Asgjë s'do të mundë ta ndalë rendjen time
drejt lumturisë.
askush s'do të mundë t'i djegë lulet që po
mbjell mbi kopshtet e varura të gjithësisë,
prandaj i gëzohem vetes dhe natyrës në këtë
breg deti
dhe shkarravis mbi rërë, kot, për trill, për
qejf.

FJALËT DHE GURËT

Fjalë dhe gurë,
fjalë dhe gurë.

C'materiale të pafund për të ndërtuar!

Kalojmë ne
mbi shkëmbinj të dalë nga toka e mbi
shkrepë,
mbi male të zhveshura, me gurë të gjallë,
mbi male të tëra me gurë;
kërcasin me dhimbje, nën shkeljet tona të
pavëmendshme, ata
dhe nga kaosi i shpërndarjes së tyre
gjëmimin e heshtur të një kori dëgjojmë!
Na vini në mur!
Na vini në mur!

Lëmënë ndjenjorë
derdhim e derdhim në detin e madh të gjuhës,
por goditemi dallgësh,

dhe stërkalemi fjalësh,
që dalin të zemëruara si nga fundi i detit;
Na vini në strofa!
Na vini në rreshta!

I dëgjoni, more njerëz?

Saq pëndovas koi të koi,
që sështë që sështë përdorët
is tillopen ushqësje uros verpofur e varf
të mungjës-së qëllës shtyhatikës
në një kohë që gjithë po statull.

Pra, kati, që është kati që kemi
s'redhaton meq mësim.

FILLIM MARSI NË MALESI

Mbi peizazhet e djegura nga të ftohtët,
lulekumbullat e para.

Ç'guxim!
Pak naiv por të pazhdukshme si vetë jetë,
shkrepëtima të bardha që shkarkojnë drejt
në zemër.

Seç këndova kot së koti,
pastaj dola të shoh piktorët
si afrohen ngadalë mos verbohen sys
nga lulet-pikime të shpejta saldatriçesh.

KY MËNGJES I MADH

DET O DET

Hapa sytë dhet kur pashë se kisha lindur
dola nga lëkura e ëndrrës dhe preka tokën.
Gjithçka ishte e vërtetë.

Atëherë zbrita me vrap nëpër thellësitë e
këngëve të heronjve,
gjer në themel e historisë njerëzore; imi
të rënët ishin ende gjallë
të prisnin.

I ngrita gjer këtu dhe u lava sytë në krojet
e tu,
ata u kthyen të gjithë në statuja.

Por, tani, për të të lënë në breza
s'mjafton veç rënia.

DET, O DET

Dhe plepat, dhe vilat, dhe qiejt u hapën.
Gjallë qenke?!

Ah, prit se mos plasem,
ndali dallgët!

I imi ti, puthma gjinë,
stërkalmë, bre, me univers!

Hahaha!
Falma dehjen.

Unë kam vetëm një jetë,
det, o det.

PEIZAZH DIMËROR

MIT NISINË VJM

Gratë ndalen dhe bisedojnë në rrugë —
sfond i ngrirë, i bardhë.

Dielli i përzier me vështrimet njerëzore
bie i valë.

NE VENDIN TIM

PRIMASHEH DIMEHOR

Vajza tē kérthndezura tani mbushin rrugët
dhe vërshojnë përmes pyllit tonë njerëzor
si një plazmë diellore,
dhe shihen me vetveten, nga pak, vjedhurazi
se si u rriten gjintë,
dhe rrahin fort jetën me femëri dhe trille
sic rreh trofta me bark ujërat në prill.

Lëkura e gurtë e rrugës,
pemët dhe pallatet
spërkaten me qumësht,
bëhen genie tē gjalla,
dridhen në ajër dhe fryjnë mbi koralet e
ndezura tē ndjenjave.

Shi i ëmbël që po bie,
shkrepëtima vështrimesh,
fytyra tē lumturish tē panjohur
grafullojnë dhe derdhen si magmë e ngrohtë
mbi kohën tonë.

Guaska e lirikës së vjetër, e çarë nën diell
çel zogj të bardhë ëndrrash që marrin jetë
sapo prekin këtë ajër, këtë tokë, këtë ozon
lirie;
çel currila gëzimesh që pllenojnë edhe
vdekjen.

TI ERDHE

Ti qesh një copë herë,
pastaj vjen me vrap dhe më hedh duart në
qafë,
pastaj qan.

Në shkëmbinjtë e thiktë të kohës
përplasesh
dhe skicohesh lehtë
si një dallgë e re mbi rërën e detit.

Tani unë me ty u bëra i përjetshëm,
por befas u tremba.
Ti kërkon të përrallesh, vetëm të përrallesh!

Po armët?

Eja të shkojmë bashkë, biri im
Gjergj.

PËLLUMBAT E PAQES

Rritni pëllumbë, fëmijë të dashur,
pëllumbë të bardhë paqeje
dhe i lëshoni në qiejt e ëndrrave tuaja të
pastra.

Fluturoni edhe ju bashkë me ta,
tutje, në hapësirat e pafundme të së ardhmes
njerëzore,
për inat të jonjerëzve,
për inat të armëve,
për inat të së keqes
pa të ardhme.

Rritni fëmijë, prindër të dashur,
fëmijë-ëndrra,
fëmijë të mrekullueshëm,
e njëkohësisht realë,
që nuk i përfytyruan dot
as ëndërrimtarët gjenialë.

Fluturoni edhe ju bashkë me ta,
tutje, në horizontet e pafundme të kësaj jetës
sonë,
për inatë të vdekjes
së verbër.

Vetëm mos rritni fëmijë-pëllumba, prindër
të dashur,
se do të na i vrasin.

4. 5. ;

PUNËTORËT SHKOJNË NË PUNË

Parakalojnë për në punë punëtorët,
fytyrat për diell u përplasen,
dielli copë-copë
bie në asfalt.

Dhe figurat e tyre ngrihen përmbi hcrizonte,
bile përmbi kreshtat e ëndrrave të nesërme,
kur ata tundin kokat:
Mirëmëngjes!

46159

VAJZAT NË RRUGË

Mbi këtë pluhur rrugë,
mbi këto lëmizhde;
mbi asfaltin e zi,
seç bie një diell
më diell se dielli.

Mbi qeniet tona
përplasen ca zëra,
që e bëkan muzikë
botën e tërë.

Ky fresk dehës
gëzimisht i çmendur
e bëka jetën
të puthë vetveten.

Dhe njerëzit ndoshta nuk e dinë
se me kë rrinë.

SHOKËT E PUNËS

Si pemë të rënduara nga frutat,
nga gaz i furtunshëm —
bisedat tonë.

Dhe burokrati,
si një bubullimë e rëndë, e largët
zbutet gjer në heshtje
kur shkrepin rrufetë.

Dhe prapë qiejt e tyre të pafund
shkunden mbi mua
duke mbjellë
lule dëshirash të diellta.

MIDIŠ NJEREZVE TË MIRE

Kam hyrë mes ajanimatit të njerëzve të mirë,
ku shokët e mi të zgjedhur s'janë më të zgjedhur,
ku Uni im shkëlqen i shumëzuar në sytë e tyre,
si një diell mbi pikat e panumërtë të vesës.

Çudi,
këtu s'paske asnje dëshirë për lavdi.

TI MË THUA

Ti ul kryet dhe vështron përqark me
druajtje,
muzgjet qeshin
si prindër të vjetër.

Të përrallemi, të përrallemi si shqerrat,
thua pak tinëz,
kurse unë jam në ty.

Ti vështron pastaj tutje e menduar
hapësiratëndërrore të pafundme.

VAJZAT E MARTANESHIT NË VALLEN FOLKLORIKE

Një shkëmb i egër. Një lëndinë.
Erdhën vajzat e Martaneshit të rrinë.

Në jekët e gjokset e mbushur i kanë,
kohën e lashtë q'na e sollën pranë.

Tek qeshin, kurmit, një nur iu bie
mendoj: me vajza legjendash po rri?

Ja, dolën në skenë me fustanella të bardha,
mbi gjithçka ra fresku i dëborës së parë.

C'shpërthyen shamitë e kuqe si flakë,
të ndezur përreth lëvizim nga pak.

Lëvizim dhe u afrohem i nga pak... në
ëndërr,
secili dhëndër.

TI HESHT

Unë kam vetëm një mënyrë të vështruari.
atë të të dashuruarit.

Pash më pash do t'i bie kësaj jetë,
i dobët jam vetëm para teje.

Ti hesht e lumiatur,
dhe përmbyt botën me qenien tënde.

PAS SHIUT

Ranë nga qelli litarët e shiut,
bota u zbraz. Asnjë krismë.

Vetëm një curril ka mbetur i varur,
i ngrirë mbi tokë si një vepër arti.

Afrohem ngadalë. Unë jam njeri.
Një vajzë. Ah, pritka dikë në shi.

E imja s'ishte. Megjithatë u kërlesha
dhe u drodha nga gëzimi. Mos qeshni.

Midis botës së kulluar, të mahnitshme të
sendeve
vetëm në ishim njerëz.

KËTA GURE

Në mokrat e ndërgjegjes sime kanë ngecur
këta gurë të gjallë malesh,
këta kufij të bardhë, të përjetshëm të qenies.

Ulërijnë hapësirat nga hija e tyre e
pälëvizshme.
Fantazitë ëndërrore, të varura kokëposhtë
mbi pafundësinë
si lakuriqë nate currojnë veshët nga frika e
rënies.

I tërbuar nga rinia e bëra rrafsh gjithçka,
e shkela me këmbë si rërë deti.
E bëra qilim fluturues ku shkas i vëtëm, i
marrë.
Mishin e bëra ndjenjë dhe ndjenjën e bëra
zjarr diellor,
dhe zjarrin diellor e bëra çerdhë
ku rris në fluturim gjithë lumturitë
njerëzore.

Vetëm këta gurë të rëndë më përplasin e më
përplasin për tokë pa zë,

sa herë më rëndet materia e tyre e vjetër
që më mban nga këmbët,
sa herë rëndet vetë historia si uloke e
mbetur në vatë.

Dhe vetëm atëherë unë shoh si më shënojnë
nga larg në thembër,
dhe vij në vete

Po unë s'jam Akili.

TË SHOHËSH

Të shohësh këtë njeri
të mirkët, të butë, të ëmbël,
ngopur me gjellë,
ngopur me diell.

'Nënë e zezë!

E paska ndukur jetën' gjer në qejf,
e paska ngrohur vendin gjer në qelbje,
i paska kërrusur ëndrrat gjer në pjatë,
i paska kthyer qiejtë në erashkë,
i paska zbutur gjer në muzikë dhome
gjëmimet e kohës sonë,
i paska ulur gjer në kënetë
dallgët rrëth vetes,
dhe si mbi një oaz lumturie
rrika shtrirë mbi mirëqenien e tij.

Desh më shkau këmba kur kalova pranë,
toka ish me jargë,
malet ishin larg,

horizontet të mbyllura
gjithë me dyllë...

Kurse ju pyesni e pyesni duke zënë hundët:
Ç'është kjo erë kështu?

NE RRUGË BIE SHI

Rrua. Shih, shih! Ç'u bë kështu?!
Piktorët, të mahnitur, mbi të u përkulën.

Ranë përbys. U ra të fiktë
Mbi rrugën që u tjetërsua, që u bë e shirtë.

Ç'janë këto stërkala të mëdha gazmore
që kërcejnë dashurisht mbi tokën tonë?

Këto reflekse të largëta kozmike nga erdhën?
(Me penela, që u dridheshin në duar, ata
mbetën).

Para këmbëve të tyre shiu mbyste dhenë
dhe i freskta mendimesh për artin dhe jetën.

SIMBIOZE

Servilët dhe burokratët,
të shkathët,
a s'i shihni si mësyjnë drejt labirinteve të
shtetit
duke ushqyer njëri-tjetrin në një simbiozë
groteske?

Ç'art, o ç'art
për t'u ngjitur më lart!
Ky arti i ngjalës, i rrëshqitjes, i fjalëve që të
verbojnë
në këto kohë që u diskredituan edhe
kameleonët.

Servilët dhe burokratët,
të ngratët,
a si shihni si gremisen shpateve të
kështjellës së shtetit
me ca mërmëritje të mbytura si lagie në
brekë?

MOTIVE MËNGJESI

Pësst!

Shtrihu njësh me relievin e rrugës!
Hesht si ajri,
përgjo si gjarpri,
hape shpellën e ndjenjës si një kataklizmë,
mos ki frikë!

Po lind dita.

Përgjo zgjimin njerëzor që parakalon
nën shiun e virgjër të rrezeve!

Përgjo shkulmin e ri të jetës
që thyen copë-copë ekranet e sekondave!

Përgjo shpalosjen flakëritëse të ëndrrave
që e bëjnë diellin të ulë sytë me turp

Përgjo ritmin e etur të hapave
që dridhen në ndjesi në barkun e nxeh të tokës
dhe e lenë me barrë!

Përgjo zërat e rinj të jetës
që muzikojnë hapësirat
dhe ndërgjegjësojnë akoma më thellë
universin!

Përgjo zhurmat e punës
që gdhendin pa pushim e pa pushim
relievin e jetës!

Përgjo dhe përleshu dhe vetë,
mos ki frikë.

Po lind dita.

BUROKRATI I FORTË

PÄRMONI

E shihja nga larg
dhe më dukej si një kështjellë e fortë
personifikim i monumentalitetit shtetëror.

Më shihte nga larg
dhe i dukesha si një ortek i zjarrtë rini,
si vetja e ikur e tij.

S'di pse u afruam,
ndoshta ashtu instinktivisht
si drejt gjérave që si kishim.
Ndoshta nga fásadát e bardha të mirësjelljes:
Mirmëngjes!
Mirmëngjes!

Kurse tani që ndeshjen tonë e mori historia
plagët vështrojmë të dy: unë lulët e shkelura të iluzioneve të mia,
dhe ai gërmadhat e burokracisë së tij.

SORRAT

Në këtë qìll të bukur të kohës sonë,
nën rrézet e diellit,
fluturuàn një tufë sorrash të zeza.

Sorr-sorra!

Sorr-sorra!

Dikush i nëmi,
dikush i ndolli,
dikush pyeti indiferent:
C'janë këto qenie?

Kurse ato fluturonin ultas mbi tokë,
ndoshta qysh nga krijimi i botës,
duke shkundur mbi gjithçka të bukur e të
mirë reflekse të hidhura.

Më erdhi krupë prej jetësisë së tyre,
më erdhi për të vjellë,
kur pashë se edhe ato përralleshin në diell.

ZONA DO NIEREZ

Kur pashë se zinin dhe hisen tonë,
mbi to qëllova.

Për ta bërë vërtet njerëzore këtë botë,
mendova me vete,
nuk duhet të zhdukim vetëm agresorët,
por dhe rutinorët e përjetshëm.

KOHA DO NJEREZ

— kundër konformistëve të vetëkënaqur —

Ju i puthni me epsh të tërbuar mëngjeset
mu në buzë,
por unë nuk shoh të lindë prej jush asnje
fëmijë drite.

Ju ecni 'dhe buzëqeshni lumturisht midis
nesh,
unë vrapoj, vrapoj t'ju prek... mermer.

Ju i ulni në tokë gjithë yllësitë e fjalëve,
unë i mahnitur i shkërmoq më duar... llak.

Ju i ngrini grushtet madhërisht drejt së
ardhmes,

kurse unë nuk shoh të hapni asnje horizont.

Ju marshoni përpara me kokën lart,
unë zbuloj i tronditür vetëm rite.

Ju.. ah, ju qenki të shtypurit nga koha,
të vrarët?!

Kurse koha do njerëz,
do shpatulla.

Dy satira

1) TË HAMË

E ndeha edhe unë më në fund nepsin mu në rrugë si një gjuhë lope; njerëzit ngecin mbi mukozë, ikin me vrap, por unë i lidh për sysh, i nomatis, i përkëdhel në bisht dhe u jap karamale si një zbutës cirku, dhe i mjel nga pak në vedrën time të shtëpisë.

Por xhindet e frysëzimit poetik currën
veshët të egërsuar:
Ej, po shkel mbi veten. Po shkel mbi veten!
Endrrën ku e le?
I tërbuar, i rraha dhe i zbrita nga koka:
Shëëëtt! Të hamë!
Nuk e shihni ç'bën' bota?

I kënaqur shtrihem tani mbi një shullë të ngrohtë të jetës
me një kokë tjeter.
Po shokët ç'u bënë?!

2) TË PIMË

Mbusha një gotë verë në pellgjet e
kuqërremta të horizonteve
dhe u putha kurvërisht me kohën tonë,
dhe gjerranat e historisë i kapërceva me
rrëshqitë,
dielli u çudit.

Tani unë po kruaj tavanin e shpellës nga
myshku
për të dalë yjet,
po e mjel jetën nga sisët e qejfit;
botën po e udhëheq vetë
për dy milionë vjet.

Shéééétt!
Qenka akoma kohë lufte.
Sillmëni një gotë barut,
shokë.

HERONJTË E KOHËS SONË

Pashë heronjtë e kohës sonë një ditë:
U çudita! Ca njerëz të thjeshtë, ca punëtorë
të ngritur madhërisht në piedestalin e kohës.

Yjet të ulur në tokë si zogjtë,
dhe dielli, midis tyre si një klogçkë,
çukitnin rrreth tyre thërrime drite.

Dhe horizontet e ardhme, të largëta, ideale
prej tyre përflakeshin,
dhe m'u dukën njerëzit, more shokë,
njerëzit,
mrekulli e mrekullive të universit.

Dhe ca hero u ndjeva edhe vetë
mbi atomin dhe supershtetet,
mbi të keqen njerëzore
që akoma kërcënon.

Tang, tang, tang! i rashë hapësirë-kohës
në portën e njohjes:
C'kanë bërë këta njerëz, ju lutem,
që ngrihen mbi botë kështu?

Ngrita kokën dhe pashë
mbishkrimin e madh:
Kanë çuar gjennë përsosmërinë e së
nesërmes
artin e rëndë të të qenit Njerëz.

PIEDESTALET

U bëra fëmijë kurioz
dhe vrapova pas kristaleve të mahnitshme
të borës
gjer në kufijtë e fluturimit jashtë botës.

U bëra dashnor i krisur
dhe vrapova pas katarakteve të dashurisë
gjer në kufijtë e marrëzisë.

U bëra mendimtar i kohës sonë
dhe bluajta gjithë universin në kokë
gjer në kufijtë e zbërthimit të tij të plotë.

Megjithatë, gjithmonë, më dukej sikur çaloja
mbi gravitacioninë e ndërror.

Vetëm kur u bëra shoku më i mirë ndër
shokë
m'u bënë piedestale edhe rrugët nga shkoja.

ÇASTE PERËNDIMI

Asnjëherë nuk e kam kërkuar të ardhmen
në quell,
as hakmarrjen
as lirinë,
por ja, u ngrit ky perëndim i madh, i kuq
dhe më përflaku në ndjesi,
dhe më ndolli dëshirash.
Endrrat fluturuau dréjt tij si zogj naivë.

U bëra masë e kuqe viskoze,
qenie èndërrorre.

Sa bukur,
sa bukur!

Por kur u ktheva të shoh veten time,
peizazhin bashkëkohor,
sytë e njerëzve,
jetën,
U lëbyra sysh,
rashë si i vdekur.

I MENDUAR

TUJJA

Sa kohë kam kështu?

Sa kohë kam që rri e vështroj këto valë
diellore

që bien dhe thahen mbi gurë,

që ngrihen kore dhe tingëllojnë madhërisht
duke zgjuar jetën,
duke zgjuar njeriun që kërcen i dehur nën
këtë simfoni?

Mendimi ngrihet si një kult duke zbehur
edhe vetë diellin.

Kush është burrë të bëjë kërcim në të
panjohurën!

Kush është burrë të zbulojë kurbëzimin e
hapësirës pranë tij si pranë masave të mëdha!
Kush është burrë t'ia shtrojë zemrat si gurë
kalldrëmi në spiralen e përpjetë të historisë,
kush është burrë ta bëjë mendimin Njeri!

Valët diellore vazhdojnë të bien,
ndërsa valët e mendimit çajnë kufijve të
pafundmë të materies.

PEMET

Në vijën e horizontit, si në ekran, lëvizin
pemët e gjalla,
përkulen nga era dhe ngrenë krye.
Dita e varur në hapësirë. Mendimi,
plumb i rëndë, përpëlitet në rrjetë si një
Ja muzika që bie,jeta. Lum kush është!
Lum kush tund krifën përjetësisht nga
gravurë e kohës.

VËLLEZËR PROLETARE

Armiqtë i kemi të shumtë, vëllezër

proletarë,
armiqjtë i kemi të fortë dhe të egër;
atar tanë po rriten,
po u bëkan perëndi.
Mjerë besimtarët!

Miqjtë i kemi edhe më të shumtë, vëllezër
proletarë,
po miqtë i kemi ca të lëkundshëm.
Kështu ndodh gjithmonë para lufte
ku duket se gjithçka mori fund.

Mjerë të hipnotizuarit!

Por ne jemi gjaku i paprishur i njerëzimit,
jemi misioni i tij i gjallë për të rrëzuar çdo
perëndi,
dhe për të ngritur mbi piedestalin e materies-
-univers
perëndinë Njeri.

Mjerë armiqjtë!

KËTË MBRËMJE EPOKE

Nën diellin e zbuar ngadalë në ekrips,
mbi tokën e heshtur, të shtrirë për flijim,
po pushoj në çastin e pritjes si në një kolltuk
të huaj.

Rrezet kullojnë në hapësirë dhe zhduken
para syve tanë,
dhe dita mbyllët si një midhje në gji të
kohës,
por unë tani e gdhenda këtë zë, këtë profil
njerezor.

Tani le të thonë: Na ishte njëherë...

KOHA JONË

Këto rreze diellore që na bien mbi krye
në historinë e materies
mund të jenë rastësi,
por gjersa ne erdhëm
dhe tani u bëmë njerëz
edhe ato bien domosdoshmërisht.

Këto ndërgjegje njerëzore që bien mbi
sendet,
mbi armiqjtë dhe mbi shokët,
mbi thelbin e së vërtetës,
jemi ne,
janë poezia dhe shkenca e jetës.

Këto sekonda që bien madhërisht nga lart,
si meteorë të zjarrtë,
janë e drejta dhe detyra jonë për të jetuar,
janë mënyra e vetme e ekzistencës,
janë koha jonë.

I shikoni?

Sapo të ndalemi pak a thjesht të heshtim,
koha erret.

ESHTË KOHA

Eshtë dikush që na thërret në jetë nga
dëshira e tij për njerëz,
eshtë dikush që na jep gji, që na jep helm,
eshtë dikush që na jep diell aq sa të jemi
për të,
eshtë dikush që na lëbyr mendsh me
hapësirat e jetës që na shfaq përparrë,
eshtë dikush që peshon qëndrimin tonë
klasor
edhe mbi dafina edhe mbi hone,
eshtë dikush që thelbin e vet na e bën
piedestale
dhe na fryn madhërisht mbi kokë.

Ose na mbulon me pluhur dhe... ikën. Koha.

HISTORIA

U ktheva prapa dhe vështrova gjurmët e mia të çuditshme, dielli i tharë mbi to, i ngritur kore, se si m'u duk, lava e ëndrrave të mia që kaléronte në qiej tanë kish ngrirë, ish kthyer në pyll statujash.

Pastaj ika tutje, me vrap, thellë historisë, i rrëmbushur nga një mall për brezat e shkuar.

Befas pamja më shtangu:
Ku jam kështu?!

Jetë njerëzore të panumërtë, që kishin gjalluar mbi faqe të dheut, që kishin ngritur kokat gëzushëm në rrugë ishin fikur me radhë si drita të vona për të gdhirë mëngjesi i epokës sonë.

Historia! Historia!

Tani e kemi radhën ne, more shokë, për të çarë edhe kufijtë e pamundësisë, dhe për të lëvizur kohën tonë

NJË LARË DIELLI

Ra një larë dielli mbi male.
Pushuan erërat,
gjithë qenia ime u nder si një koral i kuq.

P E R M B A J T J A

Valët shkojnë tutje	3
Në breg të detit	4
Fjalët dhe gurët	6
Fillim marsi në malësi	8
Ky mëngjes i madh	9
Det, o det	10
Peizazh dimëror	11
Në vendin tim	12
Ti erdhe	14
Pëllumbat e paqes	15
Punëtorët shkojnë në punë	17
Vajzat në rrugë	18
Shokët e punës	19
Midis njerëzve të mirë	20
Ti më thua	21
Vajzat e Martaneshit në vallën folklorike ...	22
Ti hesht	23
Pas shiut	24
Këta gurë	25

Të shohësh	27
Në rrugë bie shi	29
Simbiozë	30
Motive mëngjesi	31
Burokrati i fortë	33
Sorrat	34
Koha do njerëz	36
Dy satira	37
1. — Të hamë	37
2. — Të nimë	38
Heronitë e kohës sonë	39
Piedestalet	41
Caste perëndimi	42
I menduar	43
Pemët	44
Vellezër proletarë	45
Këtë mbrëmie epoke	46
Koha ionë	47
Eshtë koha	49
Historia	50
Një larë dielli	51

Huta, Hasan

Zërat e jetës: Poezi /Hasan Huta; Red.:
P. Zogaj — T.: Naim Frashëri; 1990. —
56 f.; 16 cm.

891.983-1

H 97

U dorzua për shtyp në gusht 1990
Doli nga shtypi në nëntor 1990

Tirazhi 1500 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990